



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 74

Tiranë – E martë, 3 maj 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Kuvendit
nr. 32/2016, datë 21.4.2016

Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të hetuar dhe verifikuar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”, si edhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016.....

4283

Vendim i Kuvendit
nr. 33/2016, datë 21.4.2016

Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesit të shtetit shqiptar nga realizimi i marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ a.s.”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 31/2016.....

4283

Rezolutë e Kuvendit
datë 21.4.2016

Për vlerësimin e veprimtarisë së Radiotelevizionit Publik Shqiptar (RTSH) për vitin 2015.....

4284

Rezolutë e Kuvendit
datë 21.4.2016

Për vlerësimin e punës së Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2015.....

4285

Rezolutë e Kuvendit
datë 21.4.2016

Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015.....

4287

Udhëzim i ministrit të
Financave nr. 7, datë 22.4.2016

Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 9.3.2015, “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA”

4288

Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 17.3.2016	Çështja Rista dhe të tjerët kundër Shqipërisë (ankimet nr. 5207/10, 24468/10, 36228/10, 39492/10, 39495/10, 40751/10 dhe 48522/10)	4290
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 2345, datë 27.4.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Parku Sportiv” Korçë.....	4300



**VENDIM
Nr. 32/2016**

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË HETUAR DHE VERIFIKUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJEN E INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR GJATË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE NEGOCIMI I MARRËVESHJES SË SHITJES SË AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10116, DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CEZ AS”, SI EDHE EVIDENTIMI I EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 30/2016

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e komisionit hetimor për të hetuar dhe verifikuar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe

Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”, si edhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016, si më poshtë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1. Taulant Balla | Kryetar (PS) |
| 2. Sherefedin Shehu | zëvendëskryetar (PD) |
| 3. Ulsi Manja | anëtar (PS) |
| 4. Pjerin Ndreu | anëtar (PS) |
| 5. Evis Kushi | anëtare (PS) |
| 6. Ervin Koçi | anëtar (PS) |
| 7. Bujar Derveni | anëtar (PDIU) |
| 8. Ridvan Bode | anëtar (PD) |
| 9. Gjergji Papa | anëtar (PD) |
| 10. Arben Ristani | anëtar (PD) |
| 11. Liljana Elmazi | anëtare (PD) |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 21.4.2016

**KRYETARI
Ilir Meta**

**VENDIM
Nr. 33/2016**

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJES SË INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR NGA REALIZIMI I MARRËVESHJES PËR ZGJIDHJEN ME MIRËKUPTIM NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “CEZ AS”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 31/2016

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e komisionit hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe



mbrojtjes së interesit të shtetit shqiptar nga realizimi i marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ a.s.”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 31/2016, si më poshtë:

1. Edmond Spaho Kryetar (PD)
2. Eduart Shali zëvendëskryetar (PS)
3. Vasilika Hysi anëtare (PS)
4. Blerina Gjylameti anëtare (PS)
5. Ervin Bushati anëtar (PS)
6. Robert Bitri anëtar (LSI)
7. Namik Kopliku anëtar (PS)
8. Florjon Mima anëtar (PR)
9. Jorida Tabaku anëtare (PD)
10. Gent Strazimiri anëtar (PD)
11. Helidon Bushati anëtar (PD)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË RADIOTELEVIZIONIT
PUBLIK SHQIPTAR (RTSH)
PËR VITIN 2015**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke besuar se RTSH-ja duhet të zhvillohet në drejtim të përmbushjes së misionit të vet primar për garantimin e shprehjes së interesave të publikut dhe fitimin e besimit të tij te ky organ;

- Duke theksuar se RTSH-ja ka një rol kyç në procesin e dixhitalizimit, jo vetëm në aspekt të zhvillimit të tij teknologjik dhe konkurrencën mediatike, por dhe të mundësisë së zhvillimit të mediave të tjera që do të mbështeten në rrjetet e tij numerike;

- Duke vlerësuar se organet drejtuese të RTSH-së kanë përpara një sërë sfidash në reformimin tërësor shumëplanësh të këtij organi, për të zbatuar detyrimet e tij institucionale, sipas standardeve dhe detyrimeve ndërkombëtare;

- Kuvendi i Shqipërisë, në rolin e tij ligjberës dhe kontrollues të zbatimit të ligjit, shpreh mbështetjen e tij në proceset aktuale që po zhvillon RTSH-ja në përmbushjen e procesit të dixhitalizimit, si dhe transformimit tërësor programor dhe organizativ, me qëllim që RTSH-ja të garantojë pavarësinë editoriale, përmes forcimit

të transparencës, llogaridhënies së RTSH-së para taksapaguesve të tij dhe, për rrjedhojë, edhe rritjen e audiencës publike.

Kuvendi i Shqipërisë vëren se gjatë vitit 2015:

- Veprimtaria e RTSH-së gjatë është drejtuar nga Këshilli Drejtues vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2015, pas konstituimit të plotë të tij në maj 2015.

- RTSH-së i ka munguar drejtuesi menaxherial dhe përgjegjësi editorial, pasi Këshilli nuk mundi të zgjedhë dot Drejtorin e ri të Përgjithshëm të tij, për shkak të mosarritjes së votave të nevojshme të kërkuara në ligj.

- Organet e tjera që përcakton ligji ende nuk janë formësuar për t'iu përgjigjur detyrimeve dhe përgjegjësi përkatese.

- Si pasojë e mangësisë, si dhe mungesës së organeve drejtuese, aktet nënligjore më të rëndësishme, si statuti dhe rregullorja e RTSH-së, nuk janë miratuar edhe gjatë vitit 2015.

- RTSH-ja ende nuk ka miratuar kontratën e shërbimit të transmetimit publik, ku përcaktohen parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta, duke dalë jashtë afateve ligjore për nënshkrimin e saj nga AMA.

Pavarësisht problemeve të konstatuara në këtë raport, Kuvendi vlerëson disa arritje gjatë veprimtarisë së vitit 2015, sa i takon:

- Rritjes së të ardhurave, si pasojë e arkëtimit të tarifës së aparatit marrës TV dhe përqendrimin e këtyre të ardhurave në investime për rinovimin e teknologjisë në sistemin e transmetimit, por dhe në shtimin sasior dhe cilësor të programeve;

- Nisjes së zbatimit zyrtarisht të projektit të ndërtimit të dy rrjeteve numerike të transmetimit të RTSH-së, me fillimin e fazës së parë të ndërtimit të rrjetit;

- Pasurimit të strukturës programore me disa rubrika, sidomos në fushat e ekonomisë, të artit dhe të kulturës;

- Ka vijuar realizimin dhe transmetimin e eventeve më të rëndësishme artistike, që janë zhvilluar në Shqipëri;

- RTSH-ja ka marrë pjesë rregullisht dhe ka realizuar të gjitha projektet me EBU-në;

- Është përpjekur të rrisë audiencën, duke eksperimentuar *on-line streaming* gjatë eventeve kulturore sportive ndërkombëtare;



- Ka pasur në fokus media *online* për pasqyrimin në *website* të të gjitha prodhimeve të Radio-televizionit Shqiptar, tekst, audio dhe video.

Për vitin 2016, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Këshilli i ri Drejtues të përmbushë këto detyrime:

1. Emërimin sa më parë të drejtorit të përgjithshëm, të Bordit të Administrimit dhe të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit;

2. Miratimin e Statutit të RTSH-së dhe rregullores së brendshme të organizimit;

3. Miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit publik dhe nënshkrimin e saj nga AMA, duke siguruar mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj kontrate, si dhe koordinim të ngushtë me AMA-n gjatë procesit për ndërtimin e rrjeteve numerike të RTSH-së;

4. Mbylljen e suksesshme të përfundimit të fazës së parë të ndërtimit të rrjetit numerik, sipas planifikimit në qershor–korrik 2016 dhe mbulimin me sinjal të paktën të 85 për qind të popullsisë;

5. Organizimin e një fushate të gjerë për informimin e publikut për procesin e dixhitalizimit;

6. Reformimin shumëdimensional të RTSH-së, përmes një platforme gjithëpërfshirëse, strukturore, organizative, programore e teknike;

7. RTSH-ja të sigurojnë që veprimtaria e saj të realizohet në përputhje me kërkesat e ligjit dhe statutit të vet, me qëllim që t’u përgjigjet interesave të publikut të gjerë, duke mbështetur të drejtat e shprehjes dhe të informimit, duke rritur besimin dhe audiencën e publikut të gjerë në të;

8. RTSH-ja të synojë konkurrencën mediatike dhe shtimin e të ardhurave nga mënyra e organizimit, prodhimit të programeve dhe shitjen e tyre, veprimtaritë e tjera nga shfaqjet publike apo marketing në nivele të duhura;

9. RTSH-ja të sigurojë në praktikë pavarësinë e plotë financiare, administrative dhe editoriale, në përputhje me pavarësinë e përcaktuar në ligj.

Miratuar në datën 21.4.2016

**KRYETARI
Ilir Meta**

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE PËR GJENDJEN NË
SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2015**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar reformën e administratës publike dhe zbatimin e plotë dhe efikas të legjislacionit të ri për shërbimin civil si një nga përparësitë dhe sfidat kryesore të shtetit shqiptar, për sigurimin e një administrate të pavarur, profesionale, të qëndrueshme, në përputhje me parimet e hapësirës administrative evropiane;

- Duke shprehur qëndrimin e tij se monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të ligjit dhe politikave që udhëheqin reformën në administratën publike është i domosdoshëm, përmes një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e reformës;

- Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike si institucioni publik qendror përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen, zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të misionit të këtij departamenti për administrimin e një shërbimi civil bazuar në eficiencën, konkurrencën e lirë, meritën, transparencën dhe depolitizimin, sipas standardeve evropiane;

Kuvendi vlerëson:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015–2020 dhe planin e veprimit 2015–2017, në muajin prill 2015.

2. Rolin dhe angazhimin e Departamentit të Administratës Publike, në kuadër të zbatimit të reformës në administratën publike, si një ndër 5 prioritetet e qeverisë shqiptare, vlerësuar edhe nga Komisioni Evropian në Progresraportin 2015 për Shqipërinë.

3. Mban në vëmendje vlerësimet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në raportin vjetor për vitin 2015, lidhur me përmbajtjen e procesit të rekrutimit, si dhe përpjekjet për unifikimin e zbatimit të ligjit nga Departamenti i Administratës Publike.



Kuvendi konstaton se veprimtaria e Departamentit të Administratës Publike, gjatë vitit 2015, është përqendruar në një sërë procesesh të rëndësishme:

1. Fillimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike;

2. Miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil””;

3. Organizimin intensiv të veprimtarive trajnuese nga ASPA-ja, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 152/2013, i ndryshuar, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, rritjen e kapaciteteve të administratës publike në përgjithësi dhe në menaxhimin e procesit të integritetit evropian;

5. Përmirësimin e sistemit *online* të mbledhjes së të dhënave për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shtrirjen e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përfshirë modulën e pagave, për ministritë e linjës dhe Kryeministrinë;

6. Vijimin e procesit të rishikimit funksional dhe strukturor, për të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, me qëllim ndërtimin e duhur strukturor të institucioneve;

7. Marrjen e masave për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit;

8. Projekte dhe bashkëpunime me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës dhe donatorë të tjerë të rëndësishëm në mbështetje të reformës në shërbimin civil.

Kuvendi vëren se gjatë vitit 2015:

1. Ka një tregues të ulët në tërheqjen e kapaciteteve sasiore dhe cilësinë profesionale të kandidatëve për pozicionet e punës në shërbimin civil. Nga 1005 pozicione pune të shpallura vakante, u emëruan vetëm 602 nëpunës civilë;

2. Mobiliteti në shërbimin civil për të gjitha nivelet, është realizuar me 30 për qind të totalit të rekrutimeve, me 176 nëpunës me lëvizje paralele ose ngritje në detyrë brenda shërbimit civil;

3. Numri i masave disiplinore me largim nga shërbimi civil është ulur krahasuar me vitin 2014, duke aplikuar masa alternative;

4. Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore

është i ulët. Gjatë vitit 2015 janë ekzekutuar 24 nga 150 vendime të regjistruara.

Kuvendi kërkon nga Departamenti i Administratës Publike për vitin 2016:

1. Të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të Raportprogresit për Shqipërinë për vitin 2015, në lidhje me prioritetin 1;

2. Të sigurojë zbatimin e planit të aktiviteteve afatmesme të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, 2015–2020;

3. Të vazhdojë të tregojë transparencë në procesin e rekrutimit dhe largimit të nëpunësve, bazuar në merita, në të gjitha institucionet shtetërore, me qëllim krijimin e një administrate publike profesionale dhe të depolitizuar;

4. Të ndërmarrë nisma sensibilizuese dhe stimuluese për studentët e sapodiplomuar për t'u bërë pjesë e administratës publike;

5. Të sigurojë shtrirjen e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, institucionet e pavarura dhe në të paktën 50 për qind të njësive të qeverisjes vendore;

6. Të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike, nëpërmjet trajnimit të thelluar, rritjes së cilësisë së trajnimit, si dhe forcimit të kapaciteteve në fushën anti-korrupsion, konflikt interesi, hartim legjislativ dhe përshtatje me *acquis*, si dhe të zhvillojë programe trajnimi, në përputhje me nevojat në administratën publike në nivel vendor;

7. Të garantojë raportimin e rregullt të emërimeve, lirimeve, masave disiplinore, gjendjes gjyqësore, dhe zbatimit të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, bazuar në *data base* të krijuara në çdo institucion të administratës shtetërore;

8. Të kryejë raportim periodik dhe raporte *ad-hoc*, si nga Departamenti i Administratës Publike dhe ministria përgjegjëse e tij, në Kuvendin e Shqipërisë, lidhur me çështje të caktuara të kërkuara gjatë ecurisë së zbatimit të reformës dhe strategjisë në administratën publike, si dhe mbi zbatimin e urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, i ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të

përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”.

Miraturar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN 2015**

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Rolin dhe punën e bërë nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP), si institucion i pavarur, në përputhje me atributet që i njeh ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

- Angazhimin e Zyrës së Komisionerit për të garantuar të drejtën e informimit dhe transparencën e autoriteteve publike, rolin aktiv dhe korrekt të tij, në lidhje me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatimin të ligjit për të drejtën e informimit, rolin sensibilizues të Komisionerit, në funksion të zbatimit të legjislationit për të drejtën e informimit.

- Rolin aktiv të Zyrës së Komisionerit në shqyrtimin e ankesave, zgjidhjen me ndërmjetësim, kryerjen e inspektimeve dhe hetimeve administrative në të dyja fushat, në të cilat ushtron veprimtarinë institucionale.

- Ofrimin e ekspertizës ligjore, me qëllim përshtatjen e standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale me zhvillimet e reja teknologjike.

- Procesin në rritje të numrit të njoftimeve dhe regjistrimeve nga kontrolluesit.

- Anëtarësimin në grupin e punës së artikullit 29 të direktivës 95/46 /CE.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2015:

- Zyra e Komisionerit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash në të dyja fushat që mbulon, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Ka rritur ndjeshëm numrin e inspektimeve në të drejtën për informim, në krahasim me vitin e mëparshëm.

- Ka zhvilluar monitorimin dhe mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale, nëpërmjet trajtimit të më shumë ankesave dhe rritjes së numrit të hetimeve administrative në kontrollues publik dhe privat, kryesisht në sektorë të mëdhenj.

- Ka vijuar zbatimin e ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, duke monitoruar periodikisht programet e transparencës për autoritetet publike.

- Ka përforcuar kapacitetet institucionale përmes trajnimeve, duke ofruar trajnime për titullarët dhe koordinatorët e pushtetit vendor, por edhe për shoqërinë në tërësi.

- Është bërë pjesë e strategjisë antikorruption dhe reformës në administratën publike me indikatorë konkretë.

- Ka rritur numrin e vendimmarrjeve dhe rekomandimeve, duke dhënë dhe rekomandime unifikuese në sektorë të veçantë.

- Gjatë vitit 2015, KDIMP-ja ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me ILDKPKI-në, QKR-në, QKL-në, në zbatim dhe të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të Progresraportit të BE-së për vitin 2015.

- Ka punuar për forcimin e marrëdhënieve me median dhe publikun, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me AMA-n.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2016, kërkon nga Zyra e Komisionerit:

- Rritjen e numrit të inspektimeve, lidhur me respektimin e së drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus të veçantë inspektimet kryesisht me plan tematik.

- Thellimin e hetimeve administrative, kryesisht në sektorë ku përpunohen të dhënat sensitive.

- Ndjekjen dhe zbatimin e programeve të transparencës, në mënyrë të veçantë zbatimin nga gjykatat dhe organet e qeverisjes vendore.

- Rritjen e masave administrative për shkeljet ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë rastet e refuzimit të informacionit dhe mungesës së programit të transparencës.

- Kryerjen e hetimeve administrative të thelluara, për rastet e trajtimit të ankesave abuzive, në lidhje me të drejtën e informimit.



- Kualifikimin e thelluar të kapaciteteve institucionale, nëpërmjet trajnimeve ndër-kombëtare dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

- Monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara subjekteve kontrolluese dhe përpunuese gjatë viteve 2015–2016.

- Organizimin e trajnimeve, kryesisht në sektorin medias, sistemin gjyqësor, organet e rendit dhe administratën publike.

- Rritjen ekspertizës dhe opinioneve ligjore për projektakte ligjore dhe nënligjore, të lidhura me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Angazhim në ndjekjen e procedurës për certifikimin e Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

- Hartimin dhe miratimin e strategjisë së Zyrës së Komisionerit për vitet 2017–2020.

Miraturar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 7, datë 22.4.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 9.3.2015, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR MENAXHIMIN NËPËRMJET FONDIT KOMBËTAR TË BASHKËFINANCIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR PROJEKTET IPA”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.1.2011, “Për përcaktimin

e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 10, datë 9.3.2015, “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet Fondit Kombëtar të Bashkëfinancimit të Buxhetit të Shtetit për projektet IPA”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si në vijim:

1. Në bazën ligjore të shtohen referencat si në vijim:

Ligji nr. 37/2015, datë 9.4.2015, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 18.6.2015, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural.”

1. Në pikën I, paragrafi i parë, ndryshohet në përmbajtje si në vijim:

“Strukturat e menaxhimit të decentralizuar/ indirekt, në kuptimin e këtij udhëzimi, janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.1.2011, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), komponenti I: asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 18.6.2015, “Për



përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe struk-turave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

2. Në pikën II, nënpika II.3, paragrafi i fundit, fjalia e fundit, ndryshon në përmbajtje si në vijim:

“... Më pas, lista përfundimtare i dërgohet Drejtorisë përgjegjëse për Buxhetin dhe Investimet në Ministrinë e Financave.”.

Dhe pas nënpikës pika II.3, shtohet nënpika II.4 me përmbajtje si në vijim:

“II.4. Agjencia IPARD si agjenci e pavarur, nën ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, si strukturë përgjegjëse për zbatimin e Programit IPARD II, përgatit dhe dorëzon pranë Fondit Kombëtar një parashikim/plan të fondeve IPARD II, bazuar në llogaritjet e tyre dhe fazën e implementimit të programit IPARD II për çdo masë, të kontratave të nënshkruara dhe në proces, si dhe të fazës së autorizimit dhe kontrollit të pagesave. Dorëzimi i planit bëhet duke respektuar afatet e dorëzimit të kërkesave buxhetore vjetore dhe afatmesëm.

Fondi Kombëtar shqyrton dhe krahason të dhënat/shifrat nga kërkesa e ministrisë përgjegjëse për Bujqësinë me parashikimin/planin e hartuar nga Agjencia IPARD, duke përgatitur një parashikim/plan të integruar të fondeve të IPARD II, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave.

3. Në pikën III, nënpika III.1, pas paragrafit të dytë, shtohen dy paragraf me përmbajtje si në vijim:

“Në rast rishikimi të buxhetit vjetor apo kërkesë të NJSHQP-së për rialokim të fondeve të bashkëfinancimit dhe TVSH-së për projektet e financuara nga BE-ja, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në

Ministrinë e Financave dërgon për mendim te Fondi Kombëtar çdo rishikim apo rialokim që prek fondet e parashikuara për bashkëfinancimin dhe/ose TVSH-në e projekteve të bashkëfinancuara/financuara nga BE-ja.

Fondi Kombëtar shqyrton dhe krahason të dhënat/shifrat e kërkesës për rishikim apo rialokim me parashikimin/planin e hartuar nga agjencitë implementuese (CFCU dhe/ose Agjencia IPARD) dhe brenda tre ditësh pune i kthen përgjigje Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit mbi pasojat e mundshme në implementimin e projektit /programit të IPA/IPARD II, të rishikimit /rialokimit të buxhetit sipas kërkesës së NJSHQP-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit nuk procedon me aprovimin e kërkesës së NJSHQP-së, në rast se nga Fondi Kombëtar i janë komunikuar pasoja të mundshme negative në implementimin e projektit/programit të IPA/IPARD II.

4. Në pikën III, nënpika III.2., pas paragrafit të dytë, shtohet një paragraf me përmbajtje si në vijim:

“Fondi vjetor i bashkëfinancimit të palës shqiptare nga buxheti i shtetit për programit IPARD II, i planifikuar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë nën kodin përkatës buxhetor të Agjencisë IPARD mbahet në llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë e qeverisë” në Bankën e Shqipërisë (TSA) dhe kalohet në llogarinë e Fondit Kombëtar në bankën e nivelit të dytë, sipas procedurave të përcaktuara në manualet respektive të procedurave të Fondit Kombëtar dhe Agjencisë IPARD.”.

5. Paragrafi III, nënpika II.4. ndryshohet në përmbajtje si në vijim:

“Shpenzimet që rrjedhin nga diferencat e kurseve të këmbimit dhe komisionet bankare të krijuara gjatë kryerjes së transaksioneve bankare në funksion të programeve/projekteve IPA (IPA I/IPA, II/IPARD II), mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Financave (shpenzimet operative). Fondi Kombëtar, çdo vit, duke respektuar afatet e dorëzimit të kërkesave buxhetore vjetore dhe afatmesme, përgatit dhe dorëzon pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe/ose asaj të Financës, në Ministrinë e Financave, parashikimin për fondin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve që parashikohet të krijohen nga



diferencat e kurseve të këmbimit dhe komisionet bankare të transaksioneve bankare në funksion të programeve/projekteve IPA.

Fondi i parashikuar si më sipër transferohet nga Ministria e Financave në llogaritë bankare të Fondit Kombëtar sipas kërkesave të Fondit Kombëtar/ ZKA-së.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCave
Arben Ahmetaj

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË
NJERIUT
SEKSIONI I PARË

**ÇËSHTJA RISTA DHE TË TJERËT
KUNDËR SHQIPËRISË**

(*ankimet nr. 5207/10, 24468/10, 36228/10,
39492/10, 39495/10,
40751/10 dhe 48522/10*)

VENDIM
STRASBURG
17 mars 2016

*Ky vendim është i formës së prerë. Ai mund t'i
nënshtrohet rishikimit redaktues*

**Në çështjen Rista dhe të tjerët kundër
Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Parë), e mbledhur si një Komitet i
përbërë nga:

Kristina Pardalos, *presidente*

Robert Spano,

Pauline Koskelo, *gjyqtarë*

dhe André Wampach, *zëvendësregjistrar i*

Seksionit

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 23
shkurt 2016,

Pasi ka vërejtur se çështja ligjore në fjalë në
ankesat e mëposhtme, tashmë është objekt i
vendimit të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shiko
Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë, nr.
604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §
31 korrik 2012),

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u
miratua në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me shtatë ankesa (nr.
5207/10, 24468/10, 36228/10, 39492/10,

39495/10, 40751/10 dhe 48522/10), kundër
Republikës së Shqipërisë, dorëzuar në Gjykatë,
sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të
Drejtave të Njeriut (Konventa), nga 57 njerëz me
kombësi të ndryshme. Detajet e ankuesve dhe të
përfaqësuesve përcaktohen në shtojcën nr. 1,
bashkëlidhur me vendimin.

2. Më 29 shtator 2014, trashëgimtarët e z.
Kurtesh Gjikoili, i cili ishte njëri nga ankuesit
fillestarë të ankimit nr. 24468/10, znj. Pakize
Zajmi, me mbiemrin e vajzërisë Gjikoili, znj.
Rajmonda Karapici, me mbiemrin e vajzërisë
Gjikoili dhe Adnan Gjikoili shprehën dëshirën
për të ndjekur procedurat në emër të z. Kurteshi.
Më 29 shtator 2014, trashëgimtarët e z. Nuri
Xhikaj, i cili ishte njëri nga ankuesit fillestarë në
ankimin nr. 24468/10, znj. Ganimete Xhikaj, z.
Përparim Xhikaj, znj. Dhurata Xhikaj, z. Adrian
Xhikaj, znj. Pamela Xhikaj, z. Velson Xhikaj
shprehën dëshirën të ndiqnin procedurat në emër
të tij. Më 22 qershor 2015, trashëgimtarët e znj.
Hysnije Xhikoili, e cila ishte një nga ankuesit
fillestarë të ankimit nr. 24468/10, z. Muharrem
Xhikoili, z. Burhan Xhikoili dhe znj. Edmila
Molla, me mbiemrin e vajzërisë Xhikoili,
shprehën dëshirën e tyre për të ndjekur
procedurat në emër të saj.

3. Më 19 gusht 2014, trashëgimtari i z.
Sherafedin Hasa, i cili ishte ankuesi fillestar i
ankimit nr. 36228/10, z. Erol Hasa shprehu
dëshirën e tij për të ndjekur procedurat në emër
të tij.

4. Më 11 maj 2015, trashëgimtarët e znj.
Nermin Bubani, e cila ishte njëra nga ankuesit
fillestarë në ankimin nr. 39495/10, z. Loredan
Bubani, znj. Elvana Zami, me mbiemrin e
vajzërisë Bubani dhe z. Gjergj Bubani shprehën
dëshirën për të ndjekur procedimet në emër të
saj.

5. Për arsye praktike, ankuesit z. Kurtesh
Gjikoili, z. Nuri Xhikaj, z. Sherafedin Hasa, z.
Nermin Bubani dhe znj. Hysnije Xhikoili do të
vazhdojnë të referohen në këtë vendim si ankues,
megjithëse tashmë janë trashëgimtarët e tyre që
do të referohen si të tillë (shiko *Dalban kundër
Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, § 1, GJEDNJ
1999-VI, dhe *Janowiec dhe të tjerët kundër Rusisë*
[DHM], nr. 55508/07 dhe 29520/09, §§ 97-101,
GJEDNJ 2013).



6. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj znj. A. Hicka e Zyrës së Avokatisë së Shtetit.

7. Më 20 dhjetor 2013, ankimet iu komunikuan qeverisë.

8. Në lidhje me ankimet nr. 5207/10, 36228/10 dhe 40751/10, qeveria nuk parashtrroi komente me shkrim në lidhje me kërkesat e ankuesve për kompensim të drejtë në afatin kohor të lejuar.

9. Në lidhje me ankimin nr. 5207/10, ankuesi nuk paraqiti kërkesa për kompensim të drejtë në afatin kohor të lejuar.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Ankimi nr. 5207/10: Rista

10. Më 11 maj 1995, Komisioni i Fierit i njohu ankuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë të drejtat mbi pronën e trashëguar, një sipërfaqe toke me përmasat 55,200 m², prej së cilës u rikthyen 8,186 m². Gjithashtu, u vendos që Komisioni do të merrte vendim në lidhje me kompensimin e sipërfaqes së mbetur në një moment tjetër. Më 29 janar 1999, Gjykata e Rrethit Fier amendoi vendimin e Komisionit të datës 11 maj 1995 dhe i riktheu ankuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë një sipërfaqe me përmasat 9,107 m².

11. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi paraqiti një akt civil duke kërkuar lirimin e pronës, e cila ishte zënë nga palë të treta. Palët e treta paraqitën një kundërveprim, duke kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit, të datës 11 maj 1995. Më 27 shtator 2001, Gjykata e Lartë më në fund amendoi vendimin e Komisionit në lidhje me pjesën e pronës së ankuesit, e cila korrespondon me një sipërfaqe prej 930 m². Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, Gjykata e Lartë vendosi që ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

12. Më 11 prill 2011, Gjykata e Rrethit i dha të drejtën ankuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë të apelonin, jashtë kohës, kundër vendimit të Komisionit, të datës 11 maj 1995, në lidhje me pjesën e mbetur të tokës me një sipërfaqe prej 47,014 m² (shiko paragrafin 10 më sipër). Palët nuk paraqitën informacion në lidhje me ecurinë e këtyre procedurave. Duket se procedurat kanë mbetur pezull.

13. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim në lidhje me tokën e ankuesit me sipërfaqe prej 930 m².

B. Ankimi nr. 24468/10: Gjikoili dhe Molla

14. Më 19 janar 2000, Komisioni i Tiranës, midis të tjerave, i njohu ankuesit të drejtat e pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 10,600 m². Duke qenë se sipërfaqja ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në njërin nga mënyrat e parashikuara me ligj.

15. Më 14 prill 2008, ankuesit kërkuan që sipërfaqet e pazëna me përmasa prej 3,142 m², të pozicionuara brenda tokës me sipërfaqe prej 10,600 m², t'i kthehen atyre. Më 3 dhjetor 2008, Komisioni i Tiranës e kundërshtoi ankimin e tyre duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë.

16. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim në lidhje me sipërfaqen e tokës me përmasat prej 10,600 m².

C. Ankimi nr. 36228/10: Hasa

17. Më 15 janar 2008, Komisioni i Elbasanit i njohu ankuesit të drejtën mbi pronën e trashëguar, për dy sipërfaqe tokash, në total me një sipërfaqe prej 16,500 m². Duke qenë se tokat ishin të zëna, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

18. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

